



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PRONAVE

Nr. 1106 Prot.

Fier, më 24.01.2025

Projekt - Vendim

Nr. 12 datë 24.01.2025

“Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqe “tokë pa frut”, ndodhur në fshatin Hasturkas Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier.

Në bazë të nenit 8, pika 2, nenit 54, shkronja “e/l”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510 datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësit e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo teritorial”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 375 dt. 18.05.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Libofshë Bashkia Fier Qarku Fier”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54 datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar), Udhëzimit nr. 6756, datë 03.09.2015 për “Zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54 datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”, **Kryetari i Bashkisë;**

PROPOZON

1. Të miratojë dhënien me qira të pasurisë nr. 43/2 zk. 1940 me sipërfaqe 69000 m² “tokë pa frut”, ndodhur në fshatin Hasturkas Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier, pronë e Bashkisë Fier.
2. Ky proces të kryhet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54 datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qera, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar),
3. Autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e procedurave të metejshme administrative ligjore .

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria Juridike

Drejtoreshë: E. Kapllanaj

KRYETARI

Armando SUBASHI

